

KALENDARI I BULKUT

MUAJ PRILL 2018

Të dashur bujq dhe bujkeshat të zonës së Bashkisë Vau Dejës dhe të gjithë Shqiperisë. Të dashur miq shpërndajeni sa më shumë këtë dokument nëpërmjet adresave tuaja në facebook, që t'ju vijmë në ndihmë bujqësisë shqiptare sadopak, e të kontribuojmë për më shumë informacion në këtë fushë e të bashkëpunojmë e shkëmbejmë njohuritë tona të trashëguara nga të parët tanë.

Bashkia Vau Dejës në bashkëpunim me Shkollën e Mesme Profesionale Kombëtare “Ndre Mjeda”, në Bushat në kuader të projektit “Aleanca për Zhvillimin dhe Vlerësimin e Bujqësisë Familjare”, në Veri të Shqipërisë, e financuar nga AICS-Agjensia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim dhe që zbatohet nga COSPE (për territorin e Zadrimes, Bashkisë Vau Dejës e Lezhë) e RTM për territorin e Fushe Arrës e Pukë, do të publikojnë çdo muaj kalendarin e bujkut në web site: www.zadrimatokajone.al

Eshtë një kalendar me karakter enciklopedik të dhënash, nga të gjitha fushat, e hapur për çdo lloj informacioni dhe pyetje që ju interesojnë për zhvillimin e bujqësisë, blegtorisë dhe bletarisë që lidhën me Zadrimen dhe trojet për rreth saj.

Shënim: Të gjitha pyetjet që ju do të keni në lidhje me këto probleme të drejtohen në adresën e e-mail: jakpacani@yahoo.com si edhe mund të kontaktoni në numrin e celularit: 0682067637

Të gjitha përgjigjet e pyetjeve do të përgaditen nga specialistët e profesionëve që ju drejtohen, dhe do të merrni përgjigjet në numrin e radhës në **Kalendarin e Bulkut**.

Në kalendarin e bulkut do të jepen të reja shkencore nga fusha e bujqësisë, blegtorisë, bletarisë, pyjeve, nga vendi dhe bota. Kalendarin e bulkut do të mbajë lidhje me institucione shkencore të vendit tonë dhe të vendëve të tjera. Kalendarin e bulkut nuk imponon informacionet që jepen dhe të gjitha të dhënat që jepen në këtë faqe vinë nga burime të sigurta dhe të studiuar.

Dukë qënë së kalendarin e bulkut ka edhe karakter enciklopedik dhe informativ për të gjitha shërbimet për kulturat bujqësore, blegtorale dhe bletarë që rriten e kultivohen në territorin e Zadrimes dhe të zonave malore për rreth kësaj treve (Dush, Gomsiqe, Karmë, Shllak, Temal, Mnel dhe Vig).

Meqënëse zakonisht në enciklopeditë burimi nuk referohet, por depozitohet edhe për informacionet e dhëna këtu ndodh e njëjta gjë, pra duhet të kihet parasysh se flasin gjithmonë burimet, gje që do të thote se kalendarin e bulkut fjalën e vetë e ka të pakët, të rezervuar dhe të matur.

Kalendarin e Bulkut ka vetëm karakter të informimit për të gjitha kulturat bujqësore që kultivohen, për mbareshtrimin e blegtorisë dhe bletarisë, për traditën, doket, zakonet kulturore dhe arsimin e Zadrimes dhe trojeve përreth.

Në **Kalendarin e Bulkut** do të botohen harta të ndryshme, kufinj fshatrash të vjetër, për t'ju treguar brezave si ka qenë territori i tyre ku ndër vite ku ata lindën ku ato po rriten, si edhe ato të

perspektivës. Të dhënat që jepen në këte kalendar nuk kanë kurrë farë vlere dhe force ligjore dhe nuk mundet të përdoren për zgjidhje problemesh e konfliktesh të çfarëdo lloji qofshin ato. Më poshtë po japim punët kryesore që do të bëhen dhe duhet më pasur parasysh nga ana e bujku si edhe masat që duhet të merren për mbrojtjen e kulturave bujqësore nga semundjet dhe dëmtuesit për muajn Prill 2018.

PUNIMET NE ARA

Për Bimën e Grurit.

Në kulturën e grurit gjatë muajit mars nga shirat e rënë kanë krijuar lagështirë të tepruar prandaj në qendër të vëmendjes duhet të matet kullimi edhe në vatrat e zverduara duhet të bëhet nifitimi i tyre. Në zonat fushore të Bashkisë sonë bima e grurit ndodhët në fazën e kallzimit. Ndërsa në zonat malore të territorit të Bashkisë Vau-Dejës ndodhet në fazën e ngritjes. Gjate fillimit të këtij muaji në gjethët e poshtme të grurit do të haset hiri, septorioza ku kanë prirje të ngjiten në gjethët e sipërme. Përvec këtyre do të hasim edhe afidet por nuk do të jetë nevoja për spërkatje kimike në qoftë se janë popullatë e vogël.

Në parcelat për farë të bëhet kujdes për heqjen e barojave të egra që janë konkurse për bimën e grurit, nga fundi i muajit të pastrohen varietetet të tjera që dalin në parcelen e farës.

Disa lëndë aktive për luftimin e hirit, me baze SQUFURI, CYPROCONAZOLO, BUPIRIMAT, PENCONAZOLO, MICLOBUTANIL, TRIADIMENOL, etj

Disa lëndë aktive për luftimin e afideve (morrat) BACILLUS THURINGIENSIS (Ështe Produkt Biologjik), ACETAMIPRID, AZADIRACTIN, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRINA, DELTAMETRINE, SPINOSAD (Ështe Produkt Biologjik), etj.

Për Bimën e Misrit.

Puna e parë që duhet bërë me misrin është përgatitja e tokës për mbjedhje gjatë punimeve të para të cilët zakonisht bëhen 26 cm deri në 30 cm thellësi para plugimit hidhën plehërat organike në masën 400-500 KV për hektarë. Këto të përmbysen me plugimin e parë.

Qëllimi kryesor është që të krijojmë një shtrat sa më të mirë për mbirjen e farës së misrit, para frezimit të fundit të hillen 2/3 e plehëravë kimike ndërsa 1/3 të hidhët më makinë bujqësore, të bëhet edhe dizinfektimi i tokës, të marrim masa për të siguruar ushqimet e helmuara. Mbjellja e misrit duhet të bëhet në kushte sa më optimal me lagështirë normale dhe kur temperatura e tokës në thellësin 10 cm ka arritur në 10-12 °C . Mbjellja më optimal është nga 15 - 30 Prill. Duhet të bëjmë kujdes gjatë mbjelljes së misrit për krimbat e tokës ku duhet të hellim preparate kimike për luftimin e tyre sepse në qoftë se janë prezent në tokë mund të shkaktoj dëme të medha gjatë mbirjes deri në abortimin e farës.

Disa lënde aktive për luftimin e krimbave të tokës, LAMBDA-CYHALOTHRIN, CHLORPYRIFOS ETHYL. Etj.

Për Bimën e Fasules.

Fasulet të cilët janë mbjellë në 10 diturin e fundit të muajit Mars janë në mbirje e sipër dhe gjatë 10-ditorit të parë të muajit Prill vazhdon mbjellja. Një nga dëmtuesit më kryesorë është miza e farave, në qoftë se shohim se bimët dalin me kotiledone të demtuara atëherë duhet të bëjmë capitjen në rreshtë me qëllim që të shpejtojmë daljen e bëmëve të reja mbi sipërfaqen e tokës. Pasi ky dëmtues në momentin e parë që del në kontakt me driten largohen nga bima e fasules.

Kujdes duhet të bëjmë edhe për kërmijte dhe krimbave të tokës. Këto mund ti luftojmë me preparate të ndryshme për kërmijte METALDEHYDE ndërsa për krimbin tokës preparate si LAMBDA-CYHALOTHRIN ose CHLORPYRIFOS ETHYL.

Për Bimën e Patates.

Nga fundi i muajit Prill shfaqet buberreci i patatës dhe në ditët e para të muajit Maj të merren masa për trajtime kimike.

Lëndet aktive si AZADIRACTINA, IMIDACLOPRID, , SPINOSAD (Janë Produkte Biologjike) THIAMETOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRIN, DELTAMETRINE etj.

Për Bimën e Domates Në Sera .

Më qenë se temperaturat e ambjentit janë rritur edhe lagështira është optimale krijon kushte të përshtatshme për zhvillimin e vrugut. Prandaj duhet të bëjme kujdes për trajtimin e kësaj sëmundje. Të monitorojmë çdo ditë serën për këpushat, krahbardha apo minatricen. Për sa i përket luftimit të minatricës bima e domates është më e qendrushme prandaj duhet të kemi parasysh shkallen e infeksionit kundër këtyre dëmtuesve që përmendëm më lart, trajtimet kimike bëhen vetëm në këto raste :

- Kur 7-8% e bimëve janë me afide.
- Kur 20% e bimëve kanë 10-15 gjethe janë minuara me mizën minuese.
- Kur 10 % e bimëve kanë infeksion nga këpushat.

Disa lënde aktive për luftimin e afideve (morrat) ACETAMIPRID, AZADIRACTINA, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRIN, DELTAMETRINE BACILLUS THURINGIENSIS (Janë Produkte Biologjike).

Disa lënde aktive për luftimin e krahbardhës ACETAMIPRID, AZADIRACTINA, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, ETOFENPROX, PYRIPROXYFEN etj.

Disa lënde aktive për luftimin minuesen, ABAMECTIN, SPINOSAD, AZADIRACTIN, LUFENURON etj.

Disa lënde aktive për luftimin e këpushave (merimangat) ABAMECTINE CLOFENTEZINE, HEXITIAZOX, TEBUFENPIRAD etj.

Disa lënde aktive për luftimin e vrugut BENALAXYL, MANCOZEB, FOLPET, FOSETYL-AL, CIMOXAMYL, etj.

Disa lënde aktive për luftimin e hirit SQUFURI, CYPROCONAZOLO, BUPIRIMATE, PENCONAZOLO, MICLOBUTANIL, TRIADIMENOL etj.

Për Bimën e Domates Në Fushë .

Problemet kryesore në muajin Prill për domaten në fushë janë doseza, afidet dhe barërat e egra.

Disa lëndë aktive për luftimin e afideve (morrat) dhe dosezez, ACETAMIPRID, AZADIRACTINA, IMIDACLOPRID, BACILLUS THURINGIENSIS (Janë Produkte Biologjike), THIAMETOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRIN, DELTAMETRINE etj.

Disa lende aktive për luftimin e barërave konkores të domates janë me bazë RIMSULFURON, SOLFONILUREA etj

Për Bimën e Trangullit .

Ashtu si për domaten në sera edhe për tangullin vëmendja kryesore duhe të përqëndrohet të vrugu, këpushat, afidet dhe minatricja, kjo e fundit shkakton dëme më të madh tek trangulli se sa domatja pasi trangulli është bima më pak e qëndrueshme nga kto insekte.

Disa lënde aktive për luftimin e afideve (morrat) ACETAMIPRID, BACILLUS THURINGIENSIS (Eshte Produkte Biologjike), AZADIRACTINA, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRIN, , SPINOSAD (Eshte Produkte Biologjike), DELTAMETRINE etj.

Disa lënde aktive për luftimin e krahbardhes ACETAMIPRID, AZADIRACTINA, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, ETOFENPROX, PYRIPROXYFEN etj.

Disa lënde aktive për luftimin minuesen ABAMECTIN, SPINOSAD, AZADIRACTIN, LUFENURON etj.

Disa lënde aktive për luftimin e kepushave (merimangat) ABAMECTIN CLOFENTEZIN, HEXITIAZOX, TEBUFENPIRAD etj.

Disa lënde aktive për luftimin e vrugut, BENALAXYL, MANCOZEB, FOLPET, FOSETYL-AL, CIMOXAMYL, etj.

Për Bimën e Hardhisë.

Në vreshtat nga viti I parë.

Në vreshtat e reja gjatë këtij muaji duhet të bëhen këto procese pune :

- Ku bimët kanë rritur lastaret e tyre në 3 - 4 gjethe të bëhet pastrami i gjithë filizave të dal nga nënshartesa.
- Të bëhet zverdhja e parë , kjo bëhet kështu në një ditë të vranët rreth trungut hapet dheu 20 cm thellë dhe pastrohen të gjitha rrenjët që kanë dalë si nga nënshartesa ashtu dhe nga mbishartesa.
- Toka të mbahet e pastër nga barërat e egra
- Në vendet ku nuk janë vendosur kallamat mbeshtetës të vendosen.
- Gjatë kohës në vazhdim duhet të lihen vetëm dy lastarë më të fuqishëm, lastarët e tjerë që mund të dalin duhet të hiqen.
- Me rritjen e lastarve do të dalin edhe sqetullorët keto në momentet e para duhet të hiqen vazhdimisht .
- Në ditët e fundit të këtij muaji të bëhen edhe plehërimet plotësuese me :20 gram / Nitrat Amoni .60 gram Superfosfat për çdo rrenje. Hedhja e plehut bëhet në këtë mënyrë : Në largësinë 25 cm larg bimës dhe rreth 25 -30 cm në thellësi hapet një vrimë me qyski dhe hidhet sasia e mësipërme e plehut.

Në vreshtat nga viti i dytë.

Ne 10 ditorin e muajit prill hardhitë kanë çelur dhe lastaret fillojnë të rriten me shpejtësi,

Njeri nga dy llastaret që është më I dobt i hiqet dhe lihet vetëm njëri , sqetulloret qe dalin lihen por këto pincohen ne 2-3 gjethe. Bimët lidhen ne kallamin mbështetes që të rriten sa më drejtë.

Në vreshtat e vitit të tretë .

Në vreshtat e vitit të tretë e në prodhim duhet të kemi parasysh këto proçese : me rritjen e temperaturave në 8 gradë sëmundja e hirit eshte prezente qe ne momentin e daljes se gjethe prandaj ne duhet te fillojme trajtimet me baze squfuri pasi jo vetem luftojme hirin, por edhe nekrozen dhe kepushat.

Rreth dates 20 fillon fluturimi I tejes se rrushit dhe arrine max ne fund te muajit, dhe trajtimet duhet te jene presente.

Disa lënde aktive për luftimin e kepushave (merimangat) ABAMECTINE CLOFENTEZIN, HEXITIAZOX, TEBUFENPIRAD etj.

Disa lënde aktive për luftimin e tejes , SPINOSAD (Eshte Produkte Biologjike), BACILLUS THURINGIENSIS (Eshte Produkte Biologjike),

Disa lënde aktive për luftimin e vrugut me baze BAKRI. BENALAXYL, MANCOZEB, FOLPET, FOSETYL-AL, CIMOXAMYL, etj.

Disa lënde aktive për luftimin e hirit SQUFURI, CYPROCONAZOLO, BUPIRIMATE, PENCONAZOLO, MICLOBUTANIL, TRIADIMENOL etj.

Për Bimën e Mollës .

Në fillim të këtij muaji gjethët e molles kanë celur dhe duhet të bëjme kujdes për demtuesit që janë kepusha e kuqe, afidet, flutura dimerore ndërsa semundjet janë kroma. hiri.

Disa lënde aktive për luftimin e afideve (morrat) BACILLUS THURINGIENSIS (është Produkte Biologjike), SPINOSAD (është Produkte Biologjike), ACETAMIPRID, AZADIRACTIN, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRIN, DELTAMETRIN etj.

Disa lënde aktive për luftimin e kepushave (merimangat) ABAMECTINE CLOFENTEZIN, HEXITIAZOX, TEBUFENPIRAD etj.

Disa lënde aktive për luftimin e kromes dhe të hirit SQUFURI, CYPROCONAZOLO, BUPIRIMATE, PENCONAZOLO, MICLOBUTANIL, TRIADIMENOL, CAPTAN etj

Për Bimën e Dardhës .

Në fillim të këtij muaji kanë rënë petalet dje në kohën kur petalet kanë rënë 85 % duhet të bëjmë trajtime kundër grerëzës së dardhës në qoftë se nuk trajtohet në këtë moment kur fruti i dardhës arrin madhësinë e bizeles ,dëmi është shkaktuar prandaj nuk duhet të nënvlersohet që trajtimi të kryhet pa përfunduar rënia e petaleve.

Disa nga insektet e dëmshem janë si kepusha e kuqe, afidet, flutura dimërore ndërsa sëmundjet janë kroma,hiri.

Disa lëndë aktive për luftimin e afideve (morrat) ACETAMIPRID, AZADIRACTIN, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRINA, BACILLUS THURINGIENSIS (Eshte Produkte Biologjike), , SPINOSAD (Janë Produkte Biologjike), DELTAMETRINE etj.

Disa lëndë aktive për luftimin e këpushave (merimangat) ABAMECTINE CLOFENTEZINE, HEXITIAZOX, TEBUFENPIRAD etj.

Disa lëndë aktive për luftimin e kromës dhe të hirit SQUFURI, CYPROCONAZOLO, BUPIRIMATE, PENCONAZOLO, MICLOBUTANIL, TRIADIMENOL, CAPTAN etj

Për Bimën Pjeshkës .

Gjatë këtij muaji pjeshka është në gjelberim të plotë, një nga sëmundjet më kryesore është gjethëpërdredhësja e cila bimët që nuk janë të trajtuara me lëng bordolez, janë të prekuara nga kjo sëmundje edhe Hiri është prezent, ndërsa për insektet janë afidet .

Disa lënde aktive për luftimin e afideve (morrat) ACETAMIPRID, AZADIRACTINA, IMIDACLOPRID, THIAMETHOXAN, LAMBDA-CYHALOTHRIN, DELTAMETRINE BACILLUS THURINGIENSIS (është Produkte Biologjike), , SPINOSAD (është Produkte Biologjike), etj.

Disa lënde aktive për luftimin e gjethëpërdredhësës janë me bazë BAKRI, ZIRAM, TIRAM etj

Disa lënde aktive për luftimin e hirit SQUFURI, CYPROCONAZOLO, BUPIRIMATE, PENCONAZOLO, MICLOBUTANIL, TRIADIMENOL, etj.

Për Bimën e Qershisë .

Në bimën e qershisë duhet të kemi parasysh afide të cilat kur mblidhen në popullata janë shumë të rrezikshme deri në tharje të lastareve të rinjë dhe buqetave të luleve.

Disa lënde aktive për luftimin e afideve (morrat) LAMBDA-CIALOTRINA, ACETAMIPRID, AZADIRACTINA, BACILLUS THURINGIENSIS (Janë Produkte Biologjike), IMIDACLOPRID, THIAMETOXAN, DELTAMETRINE etj.

Për Bimën e Ullirit .

Duhet të kemi nën mbikqyrje të vazhdueshme sëmundjen e syrit të palloi pasi janë kushtet shumë të favorshme për zhvillimin e saj.

Disa lënde aktive për luftimin e syrit të palloit janë preparatet me baze BAKRI, FOLPET etj

Në Bletari

- Të kryhet kontrolli në detaje i shoqerive të bletëve , nëse nuk është bërë në 10 ditorin e fundit të muajit të kaluar.
- Të shikohet zhvillimi i bletëve dhe të zgjerohet foleja si edhe duke vendosur fletë dylli të reja, fletët e reja vendosen në 2 copë një në radhën e dytë dhe tjetra në radhën e 9. Të hiqen kornizat me mjaltë të vjeter , më qellim të zgjerimit të hapsirës për t'ja mundësuar sa më shumë pjelljen e mames.
- Të hiqen kornizat me polen në kohën e lulzimit të bimeve dhe të ruhen si rezerva.
- Të mblidhet poleni i luleve me kapse.për ta ruajtur për periudha që nuk ka polen Të merren masa për ruajtjen e atmosferës së punës dhe të pengohet roitja e hershme e bletës.

Në rastet kur nuk ka kullotë të bollshme për shkak të kushteve klimatike, të vazhdohet me ushqim stimulues.

- Të bëhet bashkimi i shoqërive të dobta me të fortat, asnjherë 2 bletë të dobta nuk mund të bashkohen .
- Të bëhet kontrolli i vazhdueshëm për gjendjen shëndetësore të bletëve dhe larave. Të aplikohet lufta biologjike kundër Varoes.(kjo bëhet duke vendosur korniza pa flete dylli që bletet ti bëjnë qelizat mashkullore që kjo është streh për varroen, pastaj kjo kornize hiqet dhe grumbullohen në një vend dhe shkrihen.
Ena që shërbejnë për uje për të pirë bletet , të mbahet gjithmonë të pastër.

Konceptoi :

Agr . Jak Pacani

Agr . Aldo Game

Dok vet . Agim Alija

